



Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
Republika Kosova- Opstine Suvareka
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Nr-DATË/A:	07Nr.115 /350-17679 datë: 24.03.2022
REFERENC-Ë:	07Nr.350/17679 datë: 23.03.2022
PËR/TO:	HANDIKOS- Suharekë Nr.Kontaktues: [REDACTED]
KOPJE/COPY:	Drejtoria e Inspeksionit, Dosje të Drejtorisë Arkivin e Komunës
NGA/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
	DREJTOR: VISAR KUÇI Zyrtare e lartë për ndërtimtar: Doruntina Bytyqi ing.dipl.ndërt
LËNDA/SUBJECT:	Aktvendim mbi Lejen Ndërtimore



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr.350/17679 datë:23.03.2022 nga **HANDIKOS Shoqata për rehabilitimin e personave me nevoja të veqanta nga Suhareka**, për Leje Ndërtimore për objektin me destinim **qendër për rehabilitimin e personave me nevoja të veqanta** me etazhitet P+1 në parcelën kadastrale 00545-1, sipas çertifikatës me numër referues 11-463-1060/2022 datë 23.03.2022 Zona Kadastrale Suharekë pronë Pronë Shoqërore shfrytëzues i përhershëm Kuvendi Komunal Suharekë e dhënë me Aktvendimin Nr.07-464-2 datë 01.03.2000 nga Këshilli Komunal-Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi, andaj pas shqyrtimit të lëndës ky organ vendosi, si në Aktvendimin e bashkangjitur kësaj shkrese.

- **AKTVENDIM MBI LEJEN NDËRTIMORE**

Faqe1nga5

Adresa: Objekti i Kuvendit Komunal, Kati i Parë, nr: 026, Suharekë – Kosovë Telefon: 029 271 318
www.komuna-suhareke.org, E-mail: urbanizmisuhareke@rks-gov.net

REPUBLIC OF KOSOVA
C.O.F SUHAREKA



Data:24.03.2022

Numri i vrojtimit të lejes:

07Nr.115/350-17679

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L-031, Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Ndërtimin e Objekteve 01-Nr-16-423, datë 26.01.2011, Rregullore për tarifa nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale 01Nr-16-9367, datë 31.12.2014; neni 2, pika 2.1 dhe 2.2 si dhe Planin Zhvillimor Urban 01Nr.5820 datë:05.03.2008, kërkesës dhe dokumenteve të paraqitura nga Handikos Suharekë, DUP lëshon këtë:

**AKTVENDIM
(MBI LEJE NDËRTIMORE)**

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:

Emri:	HANDIKOS-Shoqata për rehabilitimin e personave me nevoja të veqanta	Nr. Fiskal:	
Adresa:	Rr. "Skënderbeu" Suharekë	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Aplikim për Leje ndërtimore: 07Nr.350-17679 datë:23.03.2022

Emri i Projektit:	Qendër për rehabilitimin e personave me nevoja të veqanta		
Emri i Projektuesit:	"DIARKO" Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara		
Adresa:	Rr. Qazim Berisha H3/1, 20000 Prizren		
Telefoni:		Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI, KATEGORIA II

Adresa: Rr." Skënderbeu"-SUHAREKË

Zona(t) Kadastrale: Suharekë	Nr. i parcelës kadastrale:	GPS Koordinatat e objektit:	
11-463-1060/2022 datë 23.03.2022,	00545-1	Y=7485486.981 Y=7485480.090 Y=7485487.481 Y=7485486.981	X=4691331.538 X=4691331.538 X=4691335.138 X=4691335.138

Lloji i ndërtimit të propozuar:

Qendër për rehabilitimin e personave me nevoja të veqanta

Faqe 2 nga 5

Adresa: Objekti i Kuvendit Komunal, Kati i Parë, nr. 026, Suharekë – Kosovë Telefon: 029 271 318
www.komuna-suhareke.org, E-mail: urbanizmisuhareke@rks-gov.net

Kategoria e ndërtimeve të propozuara:			
Kategoria II			
Gabariti:	(18.33m' x 19.05 m')	Katshmëria:	P+1 me sipërfaqe bruto të objektit 585.79m².
Vija rregullative:	Nga aksi i rrugës së planifikuar "Skënderbeu" është 10.5 m'. Nga aksi i rrugës së planifikuar "Motra Johana" është 4.5 m'.	Vija ndërtimore:	Vija ndërtimore nga vija rregulluese e rrugës së "Skënderbeu" 17.7 m' Vija ndërtimore nga vija rregulluese e rrugës së "Motra Johana" 4.0 m'

Përshkrimi
Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore HANDIKOS Shoqata për rehabilitimin e personave me nevoja të veqanta nga Suhareka lejohet ndërtimi i objektit me destinim qendër për rehabilitimin e personave me nevojâ të veqanta me etazhitet P+1. Lokacioni i objektit është në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, ku sipas gjendjes së planifikuar, në parcela kadastrale 00545-1 është tokë ndërtimore Hapësirë me përmbajtje publike. Objekti ka karakter të përhershëm me katshmëri P+1. Ndërtimi i objektit të bëhet konform Aktvendimit mbi Kushte Ndërtimore të lëshuara nga ky organ: 07Nr.114/350-9630 datë 23.03.2022 Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ. Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që: • Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin. • Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme: - Informata mbi Lejen Ndërtimore; - Informata mbi Projektuesin; - Informata mbi Kontraktuesin; - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit. • Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme: - Një kopje të kësaj leje ndërtimore; - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit; - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent; - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit; - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit; - Librin dhe ditarine ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur; - Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit; - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;

Duhet të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore dhe Kod. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuatë dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore. Në rast të mos respektimit të Kushteve ndërtimore, Lejes së ndërtimit si dhe në çdo parregullsi që haset në teren inspektori përgjegjës duhet të njoftoj me shkrim organin kompetent në mënyrë që të veprohet në përputhje me dispozitat ligjore. Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, Investitori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftoj organet komunale.

- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuara nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, investori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftojë organet komunale.
- Obligohet investori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njëjtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore dhe pranimit teknik të të gjitha fazave, të aplikojë për çertifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

Ar s y e t i m

Aplikuesi **HANDIKOS Shoqata për rehabilitimin e personave me nevoja të veqanta nga Suhareka**, përmes kërkesës 07Nr.350/17679 datë: 23.03.2022, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtim të objektit me destinim qendër për rehabilitimin e personave me nevoja të veqanta, sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Njoftim rreth Kushteve Ndërtimore 07Nr.114/350-9630 datë 23.03.2022 (kopje)
- Akvendimi të lejes së rrënit 07Nr.92/350-9636 datë 02.03.2022.
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.66/22, datës:17.03.2022 lëshuar nga NPRM “ ECO-REGJIONI”- Prizren, Njësia operative Suharekë.
- Vërtetim për kyqje në rrjetin publik të Ujësjiellësit dhe Kanalizimit–Hidroregjioni Jugor Prizren datë:16.03.2022.
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor–nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09Nr.614 datë:15.03.2022.
- Pëlqim për rregullim të dokumentacionit teknik, KEDS-SH.A, Nr.240, datë:21.03.2022.
- Pëlqim në dokumentacion teknik mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri, Nr.03/03-31, datë:21.03.2022 nga Drejtoria për Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjencë.
- Tri kopje të projektit zbatues dhe kopje elektronike

- Kopje e planit dhe çertifikata e pronësisë
- Qertifikatën e ARBK

Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, konform Planin Zhvillimor Urban 01Nr.5820 datë:05.03.2008, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejës Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Pala lirohet nga pagesa në pajtueshmëri me nenin 8.14.2 të Rregullores 01Nr-16-12102 datë 01.12.2015 për tarfiat, ngarkesat dhe gjobat nga shërbimet dhe veprimtarit komunale.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MMPHI në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim – Komuna Suharekë
Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.115/350-17679 datë: 24.03.2022

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Inspektoratit të Komunës;
- Dosjes së DUP-së

